

Vendim nr. 31 datë 18.04.2024

(V-31/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.04.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 43 (A) 2023 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **AGIM GOGA**

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT, përfaqësuar nga kryeinspektori Ervin Hoxha.

DREJTORIA VENDORE E POLICISË TIRANË, përfaqësuar nga drejtuesi i Parë Tonin Vocaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 5622, datë 13.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2221, datë 13.07.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-1941 (159), datë 08.05.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, pikat 1 dhe 4, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoj relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Komisarariatit të Policisë Vorë, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Agim Goga (*kërkuari*) ka fituar pronësinë për pasurinë e paluajtshme laborator fotografik, me sipërfaqe 16 m², të ndodhur në Vorë, përmes kontratës së shitblerjes të datës 02.02.1995, e cila është regjistruar rregullisht në regjistrat hipotekarë të kohës. Me vendimin nr. 270, datë 22.08.2001, dega e Policisë Ndërtimore Tiranë ka vendosur prishjen e tij, duke e konsideruar si ndërtim pa leje, vendim i cili është shfuqizuar më tej nga drejtoria e Policisë së Ndërtimit me vendimin nr. 38, datë 03.09.2001. Pavarësisht kësaj, në ditët në vijim, objekti i kërkuarit është prishur tërësisht, ndërsa një pjesë e truallit të objektit është përfshirë brenda rrethimit të Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë (postës së policisë Vorë).

2. Mbi pretendimin se objekti i është prishur nga Policia Ndërtimore dhe Komisarati i Policisë nr. 4, Tiranë, kërkuari ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara (palë të paditura në gjykimin e zakonshëm) për t'i dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar nga prishja e objektit, si dhe detyrimin e Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë për të liruar dhe dorëzuar truallin e zënë. Në vijim, ai ka depozituar aktin e datës 23.11.2001, përmes të cilit ka saktësuar dhe shtuar objektin e kërkesëpadisë, duke kërkuar shpërblimin e dëmit për fitimin e munguar nga dita e prishjes së objektit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si dhe detyrimin e të paditurve solidarisht për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme (*procesi i parë gjyqësor*).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5787, datë 25.11.2004, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke detyruar Komisaratin e Policisë nr. 4. Tiranë për të liruar dhe dorëzuar në favor të kërkuarit sipërfaqen e truallit 8 m², e cila, sipas aktit të ekspertimit të kryer gjatë gjykimit, ndodhej brenda rrethimit me kangjella të postës së policisë Vorë, edhe pse rezultonte në pronësi të kërkuarit. Po kështu, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë lidhur me shpërblimin e dëmit për fitimin e munguar, duke arsyetuar se kërkuari nuk ka arritur të provojë ekzistencën e dëmit si pasojë e veprimeve të subjekteve të interesuara, duke u mbështetur vetëm në vendimin e Policisë së Ndërtimit Tiranë, pasi ai nuk ka krijuar efekte, për sa kohë që organi administrativ më i lartë ka

korrigjuar me vendim veprimet e organit administrativ më të ulët. Po sipas gjykatës, nuk ka elemente që të provojnë se veprimet që kanë shkaktuar dëm në pronën e kërkuarit të jenë kryer nga subjektet e interesuara, si dhe nuk është kompetencë e Policisë së Rendit të prishë objektet e paligjshme ose, për më tepër, të dëmtojë objekte të ndërtuara me leje ndërtimi. Në këto kushte, gjykata ka vlerësuar se nuk ndodhet përpara kërkesave të nenit 608 të Kodit Civil (KC) për shpërblimin e dëmit të shkaktuar e aq më pak të ekzistencës së fitimit të munguar që rrjedh nga ky dëm. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuari.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1274, datë 22.12.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për sa i përket detyrimit të Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë për të liruar e dorëzuar në favor të kërkuarit sipërfaqen e truallit prej 8 m² të zënë padrejtësisht. Për kërkimet e tjera të kërkuarit gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke detyruar të paditurit, drejtorinë e Policisë së Ndërtimit dhe Komisariatin e Policisë nr. 4, Tiranë, për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme, si dhe për t'i paguar kërkuarit fitimin e munguar në shumën 3.553.474 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2007-239, datë 09.03.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit të Avokaturës së Shtetit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për interpretimin e vendimit të saj nr. 1274, datë 22.12.2005, me pretendimin se ky vendim ishte i paqartë për masën e detyrimit që duhej të shlyente secili nga të paditurit. Po kështu, kërkuari ka kërkuar nga gjykata e apelit që detyrimi i të paditurve për fitimin e munguar të shtrihej deri ditën e ekzekutimit të vendimit dhe jo deri në ditën e gjykimit, sikurse ajo ishte shprehur në atë vendim, duke detyruar të paditurit t'i paguanin shumën prej 75000 lekësh në muaj. Gjithashtu, kërkuari ka kërkuar nga gjykata e apelit të sqaronte edhe se si do të realizohej nga të paditurit përmbushja e detyrimit për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 158, datë 29.04.2010, ka vendosur pranimin e kërkesës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 1274, datë 22.12.2005 për një nga urdhërimet e tij, duke disponuar për detyrimin e të paditurve, Drejtorinë e Policisë së Ndërtimit dhe Komisariatin e Policisë nr. 4, Tiranë, t'i paguajnë kërkuarit fitimin e munguar në shumën 3.553.474 lekë në pjesë të barabarta. Lidhur me kërkimet e tjera të parashtruara në kërkesë, gjykata e apelit i ka vlerësuar ato si të pabazuara në ligj. Konkretisht, për sa i përket kërkesës në lidhje me fitimin e munguar, ajo gjykatë ka arsyetuar se përmes saj kërkuari nuk kërkonte sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 1274, datë 22.12.2005, por dhënien

e një vendim të ri, i cili ndryshonte dhe cenonte vendimin në fjalë të gjykatës së apelit dhe atë të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka vlerësuar se një pretendim i tillë mund të ishte objekt i ankimit dhe shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë, por jo i ndreqjes së gabimit, siç pretendonte kërkuesi.

7. Ndërkohë, kërkuesi ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit nr. 1274, datë 22.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, megjithatë, detyrimi për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme nga ana e subjekteve të interesuara nuk është përmbushur. Nisur nga kjo, me qëllim përfitimin e dëmshpërblimit për fitimin e munguar deri në ekzekutimin e plotë të vendimi gjyqësor të formës së prerë (pra deri në ndërtimin e objektit), në datën 27.12.2011 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e të paditurve për t'i dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar në formën e fitimit të munguar prej datës 12.10.2002 deri në ekzekutimin e plotë të vendimit nr. 5787, datë 25.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*procesi i dytë gjyqësor*). Kjo e fundit, me vendimin nr. 1461, datë 04.02.2014, ka vendosur konstatimin e mungesës së kompetencës së saj për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Përmes akteve të datave 02.10.2014 dhe 16.06.2014, me lëndë “Sqarime rreth padisë”, të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkuesi ka sqaruar se kërkimi i tij konsistonte në dëmshpërblimin në formën e fitimit të munguar nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në rindërtimin e objektit nga palët e paditura. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5622, datë 13.10.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se Gjykata e Apelit Tiranë, gjatë procesit të parë gjyqësor, e ka zgjidhur përfundimisht se cili është fitimi që kërkuesi do të realizojë në të ardhmen nëse do të vazhdonte ta kishte pronën. Sipas saj, vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohet e zgjidhur tashmë në bazë të parimit të gjësë së gjykuar. Po kështu, ajo e ka çmuar si të bazuar në ligj prapësimin e palëve të paditura lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, pasi, bazuar në nenin 115, shkronja “dh”, të KC-së, ai kërkonte fitimin e munguar për një periudhë 9-vjeçare, duke filluar nga viti 2004, në tejkalim të afatit 3-vjeçar për kërkimin e dëmshpërblimit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2221, datë 13.07.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se ky vendim ishte rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe ishte marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në

raport me faktet dhe provat objekt gjykimi. Kundër këtij vendimi në datën 23.08.2016 kërkuesi ka ushtruar rekurs.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1941 (159), datë 08.05.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se përfundimi i arritur nga kjo gjykatë është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 01.09.2023 me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 19.09.2023. Kolegji i Gjykatës në datën 20.11.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është i paligjshëm dhe shkel në mënyrë flagrante detyrimet kushtetuese për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e pronës private. Arsyetimi i saj është kontradiktor dhe në kundërshtim me ligjin. Nga njëra anë, ajo citon dhe interpreton dispozitat e KC-së për dëmin pasuror dhe fitimin e munguar, ndërkohë që, nga ana tjetër, rrëzon kërkesëpadinë, në kundërshtim me këto parashikime. Po kështu, arsyetimi i saj se kërkesëpadia përbën gjë të gjykuar nuk qëndron, për sa kohë që prej vetë gjykatës është interpretuar se fitimi i munguar është ai fitim që subjekti i dëmtuar do të realizonte në të ardhmen. Edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe normat ligjore për të njëjtat shkaqe dhe për të njëjtat arsytetime të paligjshme.

12.2. *Së drejtës së pronës private*, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë garantuar atij pronën private, si dhe i kanë bërë të pamundur përfitimin e shpërblimit të drejtë të pronës në vijim të prishjes të saj në mënyrë të kundërligjshme nga institucionet shtetërore. Dëmshpërblimi në formën e fitimit të munguar, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i takon periudhës kohore nga momenti i prishjes së objektit në vitin 2001, deri në momentin e shpalljes së vendimit nr. 5787, datë

25.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë, pretendimi i ngritur përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka lidhje me dëmshpërblimin në formën e fitimit të munguar që i përket periudhës pas shpalljes së vendimit gjyqësor të mësipërm deri në ekzekutimin e detyrimit kryesor nga palët e paditura, që është ndërtimi i objektit në gjendjen e mëparshme. Ky është një kërkim i ri, i cili, fillimisht, është pasqyruar gabim në objektin e kërkesëpadisë dhe, në vijim, është kërkuar saktësimi i tij në seancën përgatitore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

13. Subjektet e interesuara, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në thelb, kanë paraqitur të njëjtat argumente dhe, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar, si vijon:

13.1. Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi interpretimi dhe zbatimi i ligjeve qëndron jashtë juridiksionit kushtetues. E kundërta ndodh në rastin e kërimit të interpretimit të dispozitave kushtetuese, ku Gjykata ka rolin e interpretuesit përfundimtar të Kushtetutës. Shqyrtimi i pretendimeve për themelin e çështjes është pjesë e juridiksionit të gjykatave të faktit dhe Gjykatës së Lartë, në rastin eventual të rekursit ose mjeteve të tjera ankimore të parashikuara nga ligji procedural. Kërkesa nuk reflekton ndonjë problematikë me natyrë kushtetuese dhe në këto kushte duhet rrëzuar për mungesë juridiksioni.

13.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar, pasi në rastin objekt gjykimi nuk ekziston kufizimi i së drejtës për akses në gjykatë, për sa kohë kërkuesi nuk provon se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tij. E drejta e aksesit ose të drejtat e tjera procedurale nuk garantohen domosdoshmërisht dhe vetëm duke e paraqitur çështjen në seancë publike. Gjykata e Lartë është gjykatë ligji dhe jo fakti dhe ajo ka të drejtë të investohet vetëm në çështje që kanë të bëjnë me shkelje të rënda të ligjit procedural dhe material.

13.3. Pretendimi për cenimin e parimit të kontradiktoritetit është i pabazuar. Në lidhje me zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit, Kolegji Administrativ ka revokuar vendimin e ndërmjetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për të vijuar shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, vendim i cili u është komunikuar palëve. Në këto kushte nuk rezulton që kërkuesi të jetë vendosur në pozita të pabarabarta me subjektin e interesuar.

13.4. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur është i pabazuar, pasi në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt ligjor, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Kërkimet dhe argumentet në përmbajtje të kërkesës nuk reflektojnë ndonjë problematikë të natyrës kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij. Pretendimet e tij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe së drejtës së pronës janë ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë ka përmbushur në formë dhe substancë kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-1941(159), datë 08.05.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 01.09.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor në kuptim të dispozitës së lartpërmendur. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

19. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe të drejtën e pronës private, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës.

20. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkesa nuk reflekton ndonjë problematikë me natyrë kushtetuese dhe në këto kushte duhet rrëzuar për mungesë juridiksioni, pasi interpretimi dhe zbatimi i ligjeve qëndron jashtë juridiksionit kushtetues. Gjykata vlerëson se edhe pse subjektet e interesuara kanë kundërshtuar juridiksionin e saj për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të kërkuetit, argumentet e tyre kanë të bëjnë me legjitimimin *ratione materiae* të pretendimeve të tij. Në këtë këndvështrim, duke qenë se kërkuesi pretendon se i është mohuar e drejta e tij e pronës private përmes një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ndryshim nga sa kanë prapësuar subjektet e interesuara, nisur nga përmbajtja e pretendimeve të tij, pra cenimi i të drejtave kushtetuese si pasojë e vendimmarrjes së këtyre gjykatave, Gjykata çmon se ato përfshihen në juridiksionin kushtetues.

21. Gjithashtu, Gjykata konstaton se përkundrejt pretendimeve të kërkuetit, subjektet e interesuara, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në prapësimet e tyre në themel kanë argumentuar për disa të drejta dhe parime kushtetuese, asnjë prej të cilave nuk lidhet, qoftë edhe tërthorazi, me pretendimet e

ngritura nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se prapësimet e subjekteve të interesuara për themelin e çështjes nuk mund të merren në konsideratë.

22. Për sa u takon pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, duke qenë se argumentet mbi të cilat ai ka bazuar pretendimin e tij për cenimin e së drejtës së pronës private janë të ndërvarura me ato për cenimin e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon që çështja e paraqitur të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për sa i takon së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ajo përfshin, ndër të tjera, edhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Prandaj, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi parashtron se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë dhënë në kundërshtim me ligjin, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të tij në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronës private.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private

23. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është i paligjshëm dhe shkel në mënyrë flagrante detyrimet kushtetuese për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e pronës private. Arsyetimi i saj është kontradiktor dhe në kundërshtim me ligjin. Nga njëra anë, ajo citon dhe interpreton dispozitat e KC-së për dëmin pasuror dhe fitimin e munguar, ndërkohë që, nga ana tjetër, rrëzon kërkesëpadinë, në kundërshtim me këto parashikime, duke konsideruar se kërkesëpadia përbën gjë të gjykuar. Edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe normat ligjore për të njëjtat shkaqe dhe për të njëjtat arsyeime të paligjshme. Ato nuk i kanë garantuar atij pronën private, si dhe shpërblimin e drejtë për shkatërrimin e saj në mënyrë të kundërligjshme nga institucionet shtetërore. Dëmshpërblimi në formën e fitimit të munguar, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i takon periudhës kohore nga momenti i prishjes së objektit në vitin 2001 deri në momentin e shpalljes së vendimit nr. 5787, datë 25.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë, pretendimi i ri ka lidhje me dëmshpërblimin në formën e fitimit të munguar që i përket periudhës pas shpalljes së vendimit gjyqësor të mësipërm deri në ekzekutimin e detyrimit kryesor nga palët e paditura, që është ndërtimi i objektit në gjendjen e mëparshme.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar përkon me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Po kështu, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. E drejta e pronës private është e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Edhe Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës private përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. E drejta e pronës realizohet përmes ushtrimit të tagrave të pronësisë dhe se cenimi qoftë edhe i pjesshëm i çdo tagri të pronësisë përbën, në vetvete, cenimin e së drejtës të pronës në tërësinë e saj (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36 datë 21.04.2017; nr. 25, datë 28.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se për shkak të prishjes në mënyrë të paligjshme të objektit laborator fotografik në pronësi të kërkuarit, gjatë procesit të parë gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit, me qëllim përcaktimin e dëmit të shkaktuar nga prishja e objektit, si dhe të fitimit të munguar nga moskryerja e aktivitetit nga momenti i prishjes së objektit deri në momentin e gjykimit. Në aktin e ekspertimit të datës 14.10.2004 rezulton se është përlllogaritur dëmi që përbëhet nga vlera e godinës së prishur në shumën 817.474 lekë dhe vlera e fitimit të munguar për

moskryerje të aktivitetit në shumën prej 2.736.000 lekësh për periudhën nga momenti i prishjes së objektit në vitin 2001 deri në datën 18.09.2004. Në total akti i ekspertimit ka llogaritur një dëm në shumën prej 3.553.474 lekësh, vlerë e cila është përcaktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë si detyrim që palët e paditura duhet t'i paguajnë kërkuesit. Përveç këtij detyrimi, gjykata e apelit për subjektet e interesuara ka përcaktuar edhe detyrimin për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme. Ky vendim nuk rezulton të jetë kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nga kërkuesi, por vetëm nga Avokatura e Shtetit.

27. Gjatë procesit të dytë gjyqësor, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se Gjykata e Apelit Tiranë në procesin e parë gjyqësor, ndonëse ka disponuar edhe për detyrimin e të paditurve për ndërtimin e objektit në gjendjen që ka qenë, në lidhje me njohjen e së drejtës për fitimin e munguar dhe llogaritjen e tij, për vetë konceptin që ka fitimi i munguar, e ka zgjidhur përfundimisht se cili është fitimi që paditësi (kërkuesi) do të realizonte në të ardhmen, nëse do të vazhdonte ta kishte pronën e tij. Në këtë mënyrë, sipas saj, pretendimi i kërkuesit për fitimin e munguar, që rrjedh nga mospërmbushja e detyrimit të palës së paditur për ndërtimin e objektit në gjendjen që ka qenë, është i pabazuar në ligj, pasi kjo e drejtë i është njohur në masën konkrete në atë gjykim, duke nënkuptuar pikërisht mospasjen e pronës. Në këto kushte, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohej e zgjidhur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*). Po kështu, ajo e ka gjetur të bazuar prapësimin e të paditurve për parashkrimin e kërkesëpadisë së kërkuesit, referuar nenit 115, shkronja “dh”, të KC-së, duke arsyetuar se ai kërkonte shpërblimin e dëmit jokontraktor në formën e fitimit të munguar pas një periudhe 9-vjeçare, duke filluar nga viti 2004, pra në tejkalim të afatit 3-vjeçar për kërkimin e dëmshpërblimit (*shih faqen 5 të vendimit nr. 5622, datë 13.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

28. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se gjykatat kanë disponuar për sa i përket së drejtës së kërkuesit për të përfituar fitimin e munguar, si dhe lidhur me përcaktimin e masës konkrete të këtij përfitimi, si pasojë e dëmit të shkaktuar pronës së tij në mënyrë të paligjshme. Ato kanë përcaktuar pikërisht fitimin që subjekti i dëmtuar do të realizonte në të ardhmen, sikur të mos ishte shkaktuar ngjarja e dëmshme. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se për sa është kërkuar nga kërkuesi në objektin e padisë, çështja është zgjidhur përfundimisht me vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimi nr. 1274, datë 22.12.2005 i Gjykatës së Apelit Tiranë) dhe pretendimi i tij për fitimin e munguar, që rrjedh nga mospërmbushja e detyrimit të palës së paditur për ndërtimin e

objektit në gjendjen që ka qenë, është i pabazuar në ligj, pasi kjo e drejtë i është njohur palës paditëse në masën konkrete. Gjithashtu, ajo gjykatë e ka konsideruar të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me parashkrimin e padisë (*shih faqet 8-9 të vendimit nr. 2221, datë 13.07.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

29. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kërkuessit i është njohur fitimi i munguar me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është përcaktuar edhe vlera konkrete financiare, ndaj rasti konkret përbën gjë të gjykuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim të mëparshëm dhe që nuk mund të gjykohej përsëri. Ndër të tjera, ai ka vlerësuar se argumenti i kërkuessit se ka kërkuar shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të munguar pas dhënies së vendimit të gjykatës është i pabazuar në ligj, pasi gjykatat ia kanë dhënë kërkuessit fitimin e munguar për të gjithë kohën dhe vlera e tij është e tillë që përfshin edhe përdorimin në të ardhmen, prandaj kjo pjesë përbën gjë të gjykuar, duke iu referuar natyrës dhe përmbajtjes së kërkimeve të paditësit të gjykuara me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa vonesat në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, sipas atij kolegji, nuk lënë shkas për paraqitjen e një padie për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, për sa kohë që kërkuessi ka mundësi të ndjekë mjetet e ekzekutimit të detyrueshëm të parashikuara në KPC, ndërkohë që pretendimet për rindërtimin e objektit lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ku qartësisht ligji procedural ka parashikuar mënyrën dhe procedurën e ekzekutimit të tij (*shih paragrafët 18 dhe 19 të vendimit nr. 00-2023-1941 (159), datë 08.05.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

30. Nga analiza e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuessit për të përfitur dëmshpërblim në formën e fitimit të munguar deri në zbatimin e detyrimit kryesor nga palët e paditura për ndërtimin e objektit të prishur në gjendjen e mëparshme. Vendimmarrja e tyre mbështetet në arsyetimin se: (i) kërkuessi e ka përfitur më parë shpërblimin e dëmit të shkaktuar në formën e fitimit të munguar me vendim gjyqësor të formës së prerë (*procesi i parë gjyqësor*) dhe vlera e tij është e tillë që përfshin edhe përdorimin e objektit në të ardhmen, duke vlerësuar se çështja objekt i procesit të dytë gjyqësor (e kundërshtuar nëpërmjet ankimit kushtetues individual) përbën *res judicata*; (ii) kërkesëpadia është parashkruar, duke konsideruar se dëmshpërblimi kërkohet prej vitit 2004 nga data e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë dhe neni 115, shkronja “dh”, i KC-së parashikon një afat 3-vjeçar për parashkrimin e padisë për shpërblimin e dëmit, argument ky që nuk ka gjetur përkrahje nga Gjykata e Lartë.

31. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se në kushtet kur në procesin e parë gjyqësor kërkuessi ka kërkuar edhe shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të munguar për

periudhën nga dita e prishjes së objektit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ndërsa nuk ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr.1274, datë 22.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes të cilit është vendosur detyrimi i të paditurve për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme, si dhe për t'i paguar kërkuarit fitimin e munguar në shumën 3.553.474 lekë, ai, në këtë mënyrë, ka pranuar fitimin e munguar në masën e caktuar, pavarësisht mënyrës dhe periudhës së përlllogaritjes së tij. Për sa kohë ky vendim nuk është kundërshtuar nga kërkuarisi, ai përbën gjë të gjykuar. Ashtu si ka vënë në dukje Gjykata e Apelit Tiranë gjatë shqyrtimit të kërkesës për interpretimin e vendimit të saj, pretendimet e tij, që në thelb kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa ajo ka disponuar në lidhje me fitimin e munguar, duhej të ishin bërë objekt i mjetit të ankimit dhe më pas i vlerësimit nga një gjykatë më e lartë, por jo i një kërkimi të ri. Ndërkohë, për sa u takon pretendimeve të tij për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme, sikurse ka arsyetuar edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ato lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor, për të cilin ligji procedural ka parashikuar mjetet dhe procedurën e ekzekutimit të tij.

32. Në këndvështrim të sa më lart, në kundërshtim me sa pretendon kërkuarisi, Gjykata çmon se arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk rezulton të jetë kontradiktor ose i paqartë në formë dhe përmbajtje. Gjithashtu, nuk rezulton që gjykatat të kenë zbatuar ligjin në mënyrë arbitrare, duke respektuar në këtë mënyrë standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, për rrjedhojë vendimmarrja e gjykatave nuk ka cenuar as të drejtën e pronës private të kërkuarit.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private nuk janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri.

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.04.2024

Shpallur më 16.05.2024